



Матерњи језик - Албански

EKZEMPLAR PËR NXËNËSIN

Republika e Serbisë
MINISTRIA E ARSIMIT
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË
ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR

TESTI

GJUHË DHE LETËRSI SHQIPE

FORMULARI I IDENTIFIKIMIT

EMRI, EMRI I NJËRIT PRIND/PËRFAQËSUESIT TJETËR LIGJOR, MBIEMRI I NXËNËSIT

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË NXËNËSIT

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

SHKOLLA FILLORE _____
VENDI _____
KOMUNA _____

NËNSHKRIMI I MËSIMDHËNËSIT KUJDESTAR

Rezultatet mund të shihen në portalin **Moja srednja škola**: <https://mojasrednjaskola.gov.rs> duke vendosur numrin e veçantë identifikues të nxënësit (shifra dhjetëshifrore e nxënësit). Për shkak të shkarkimit të testit në Pdf format, në pjesën ku mund të shihni rezultatet e provimit përfundimtar, është e domosdoshme të vendosni shifrën e veçantë të testit.

Shifra e veçantë e testit: 224202511461

Nëse prindi/përfaqësuesi tjetër ligjor ka një llogari të hapur në portalin **Moj esDnevnik** ose ka një llogari në **Portal za elektronsku identifikaciju eID.gov.rs**, me të cilin mund të qaset në portalin **Moj esDnevnik**, atëherë përveç që mund të ketë qasje në rezultatet e testit përfundimtar, në portalin **Moja srednja škola**, mund të shfrytëzojë edhe shërbimet tjera elektronike si: paraqitja e ankesës ndaj rezultateve të testit përfundimtar, të dërgojë listën elektronike të dëshirave për regjistrim dhe paraqitjen apo aplikacionin elektronik për regjistrim në shkollë të mesme.

UDHËZIME PËR PUNË

- Testi të cilin duhet ta zgjidhësh ka **20 detyra**. Për të plotësuar testin në dispozicion ke **120 minuta**.
- Shkruaj mirë, në mënyrë që shkrimi të jetë i lexueshëm, duke pasur kujdes që përgjigjet e tua të jenë të kuptueshme, të shkruara sipas rregullave drejtshkrimore dhe gramatikore.
- Kur të zgjedhësh detyrat tek të cilat duhet të shkruash diçka, gjithmonë përdor emërtimet e plota; shkurtesat nuk janë të lejueshme (p.sh. duhet të shkruash emri, e jo em., ose gjinore e jo gjin., ose të shkurtesa tjera të ngjashme)
- Plotëso testin me **laps kimik ngjyrë të kaltër** (gjatë punës mund të përdorësh laps të thjeshtë grafik dhe gomë).
- Përgjigja e cila është e shkruar vetëm me laps të thjeshtë grafik, laps kimik ngjyrë të zezë ose laps “shkruaj – fshij” nuk do të pranohet.
- Tek detyrat me opsione, nuk do të pranohen përgjigjet e përmirësuar.
- Bëj kujdes, sepse detyrat dallojnë për nga mënyra sipas të cilës duhet të përgjigjesh.
- Në detyrat me opsione do të marrësh 0 pikë nëse përveç përgjigjes së saktë ngjyros apo nënvizon edhe ndonjë përgjigje të pasaktë.
- Mos shkruaj asgjë mbi QR kodet () , të cilët gjenden në çdo faqe të testit.

Tek disa detyra do të zgjedhësh përgjigjen e saktë ashtu që do të ngjyrosësh rrethin e duhur. Tek detyrat ku ekzistojnë më tepër përgjigje të sakta është e nevojshme të ngjyrosen më shumë rathë. Kujdesu që rrethi të jetë patjetër i ngjyrosur, sepse vetëm ashtu përgjigja do të pranohet si e saktë.

SHEMBULL I RRATHËVE TË NGJYROSUR	
Tek detyra me një përgjigje të saktë	
Cili është kryeqyteti i Republikës së Serbisë? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.	
☐ Novi Sadi ☒ Beogradi ☐ Nishi ☐ Krushevc	
Tek detyra me më shumë përgjigje të sakta	
Ngjyros rathët para shprehjes, shuma e të cilës është 5.	
☒ 2 + 3 ☐ 1 + 2 ☒ 4 + 1 ☐ 2 + 4 ☐ 3 + 5	

- Nëse përfundon më herët testin se sa koha e paraparë, dorëzo testin dhe largohu në qetësi.

Të dëshirojmë shumë suksese në provim!



TESTI GJUHË DHE LETËRSI SHQIPE

1. Lexoni me vëmendje tekstin e dhënë:

I erdhi më në fund radha sirenës së vogël, që mbushi pesëmbëdhjetë vjet.

- Do të niseshe, - i tha nëna mbretëreshë, - hajde të të stolis si motrat e tua.

Dhe i vuri në leshrat e saj një kurorë zambakësh të bardhë që e kishin fletën sa gjysma e një margaritari; pastaj lidhi në bishtin e princeshës tetë guaska të mëdha për të dalluar sojin e saj të madh.

- Sa më vrasin! – tha sirena e vogël.

- Po deshe të vishesh mirë, duhet ta durosh dhembjen, - iu përgjigj nëna mbretëreshë.

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

Teksti më lart është:

- ☐ tekst letrar
- ☐ tekst joletrar

2. Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

Në fjalinë e dhënë: **Nuk** mund ta pyes., fjala me të zezë është:

- ☐ nyjë
- ☐ parafjalë
- ☐ lidhëz
- ☐ pjesëz
- ☐ pasthirmë

3. Cili prej nënlojeve të teksteve nëpërmjet gjuhës (të dhëna nëpërmjet fjalive më poshtë) është *letër*?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- ☐ Duhet të flasësh me zë të ulët!
- ☐ I dashur mik...
- ☐ 1 kg biskota, 1 kg sheqer, 1 kg molla...
- ☐ Me ne më pranë dijes!





4. Duke ngjyrosur rrethin para përgjigjes së saktë, trego çfarë janë fjalët: *sivjet, përmbi, faleminderit, gjithnjë* dhe *tridhjetë*.

- ☐ Fjalë të prejardhura
- ☐ Fjalë të përbëra
- ☐ Fjalë të përngjitura
- ☐ Fjalë të parme

5. Lexo me vëmendje fjalinë e dhënë më poshtë dhe ngjyros rrathët poshtë fjalëve që shënojnë gjymtyrët e dyta.

Mimi vuri mollët në një shportë të madhe.

- ☐ ☐ ☐ ☐ ☐

6. Pranë fjalëve të dhëna shkruaj kuptimin e tyre në gjuhën shqipe.
Plotëso vendin bosh me vizë për të dhënë përgjigje të saktë.

Abuzoj _____

Avantazh _____

Barrierë _____

Аparencë _____

Aktivitet _____

Bulevard _____

7. Duke ngjyrosur rrethin në shtyllën përkatëse, ndërlidh veprën me autorin e saj.

	"Antigona"	"Kënga e sprasme e Balës"	"Ali Pashë Tepelena"
Sabri Godo	☐	☐	☐
Gavril Dara (i riu)	☐	☐	☐
Sofokliu	☐	☐	☐





8. Lexo me vëmendje tekstin në vijim dhe përgjigju sipas kërkesës më poshtë.

Pranvera

Shiu tashmë kish pushuar. Ta kish ënda të shikoje ngjyrën e kaltër e shumë të bukur të qiellit. Aty -këtu, ca re si elefantë të ngarkuar kapul me pambuk endeshin ngadalë nga një horizont në tjetrin, duke i dhënë pamjes një hijeshi më vete. Aq shumë afër dheut dukej qielli, sa retë e dendura e të bardha si pambuk në lëvizje binin mbi majat e sukave dhe të pemëve, bëheshin copë-copë dhe dukej sikur qëndronin në vend.

Toka, e çelur nga gëzimi, po fitonte sërishmi freskinë e saj nën afshin jetëdhënës të diellit dhe nën dritën e tij të bukur. Nga dheu i ujshëm dilte një avull që shkonte drejt nga qielli.

Era që frynte lehtë bënte që të fërfëllonin vetëm gjethet, pa trazuar fare degët. Duke parë se do të shpëtonte nga dora mizore e dimrit, Toka po priste gjithë gaz pranverën dhe po ndodhej pranë në të gjitha ndryshimet e mëdha të natyrës. Me një fjalë, Tokë e Qiell po nënqeshnin të gazuar.

Nga “Katër stinët” – Naim Frashëri

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

Mënyra e rrëfimit në tekstin e mësipërm është:

- ☐ përshkrim ☐ dialog ☐ monolog

9. Lexo me vëmendje vargjet e dhëna.

Ngjyros rrethin (rrathët) poshtë fjalës (fjalëve) që krijon (krijojnë) epitete për të dhënë përgjigje të saktë.

Krujë, o qytet i bekuar,

- ☐ ☐ ☐

prite, prite Skënderbenë,

- ☐ ☐ ☐

po vjen si pëllumb i shkruar,

- ☐ ☐ ☐ ☐

të shpëtojë mëmdhenë.

- ☐ ☐





10. Korrigjo fjalitë e shkruara gabimisht më poshtë.
Shkruaj ato si duhet duke plotësuar vendin bosh me vizë.

ministra ekonomisë - _____

Akademia e shkencave - _____

Fakulteti filologjisë - _____

Partia për të drejtat e njeriut - _____

11. Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

Te fjala *mesnatës*, shkronja - s fundore (shkronja me të zezë) është:

☐ parashtesë ☐ prapashtesë ☐ mbaresë ☐ temë

12. Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

Lexo me vëmendje fjalinë e dhënë.

Nëpër shpella nën dhe, ku s'futej dielli kurrë dergjeshin si milingonat.

Pjesa me të zeza e fjalisë është:

☐ pjesë e nënrenditur mënyrore
☐ pjesë e nënrenditur vendore
☐ pjesë e nënrenditur përcaktore
☐ pjesë e nënrenditur filluese

13. Lidh foljen *punoj* me mënyrën që i përgjigjet duke ngjyrosur rrethin në shtyllën përkatëse.

	Mënyra lidhore	Mënyra kushtore	Mënyra habitore	Mënyra dëshirore
<i>punofsha</i>	☐	☐	☐	☐
<i>punuakam</i>	☐	☐	☐	☐
<i>të punoj</i>	☐	☐	☐	☐
<i>do të punoja</i>	☐	☐	☐	☐





14. Shiko me vëmendje shprehjet e dhëna dhe përgjigju sipas kërkesës më poshtë.

*U bën pikë e pesë.
Si pula pa krye.
I shkon për shtati.
Bëji sytë katër.*

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

Shprehjet e dhëna më lart janë:

- ☐ sinonime ☐ antonime ☐ frazeologizma

15. Vargjet në vijim janë vargjet më tragjike ku poeti derdh dhimbjen për humbjen e njeriut të dashur. Lexoji me vëmendje.

Vaje

*Doje dritë o qiell more dritën time
dhe ma mbushe jetën plot me hidhërime*

*Tani rroj pa shpresë ndaj s'dua të rroj
Se dhe perëndinë tani s'e besoj.
Nga Andon Zako - Çajupi*

Ngjyros rrathët para përgjigjeve të sakta.

Personazhi tragjik i vargjeve më lart vuan:

- ☐ dramën e nënës
☐ dramën e babait
☐ lidhjen e njeriut me perëndinë
☐ dramën e bashkëshortit
☐ zhgënjimin e njeriut me perëndinë
☐ dramën e djalit
☐ dramën e vajzës





16. Lexo me vëmendje vargjet e mëposhtme dhe cakto figurën stilistike që është përdorur.

*Shushurijnë shelgjet në fushë, shushurijnë;
Mërmërijnë mizat në mriz, mërmërijnë.
O Zot,
Lësho një bubullimë.*

Nga Xhevahir Spahiu

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

Në poezi është paraqitur figura stilistike:

- ☐ metafora
- ☐ aliteracioni
- ☐ onomatopeja
- ☐ personifikimi

17. Kjo pjesë është shkruar nga Faik Konica. Lexojeni me vëmendje.

Bora

Kthjelltësia e qiellit shkoi me diellin, me lulet, me verën. Vjeshta e trishtueshme erdhi dhe iku. Tani po hyn dimri edhe qiellin e kanë mbuluar re të qeta e të ftohta. Edhe sot, për të parën herë, zu të bjerë bora.

Prapa qelqeve të dritares po shikoj. Ngadalë, ngadalë, sikur ka frikë të dëgjohet, bora fluturon flokë-flokë, e shtrohet mbi dhe. Bie kudo, e duket sikur kërkon të ndreqë e të zbukurojë. Dy çupa të vockëla shkojnë, e, në leshërat e tyre të arta, të lëshuara mbi shpatulla, bora shkruan trëndafile të argjendta. Djemtë qeshin, hidhen, luajnë e luftojnë me topa. Zogjtë rreth e rrotull parqeve, ciu, ciu, një thërrime buke!

Si në verë, gjithë bota është veshur në të bardha.

Flokë-flokë, ngadalë po bie bora...

Duke ngjyrosur rrethin para përgjigjes së saktë trego se cilit lloj letrar i takon vepra "Bora".

- ☐ poezi
- ☐ tregim
- ☐ prozë poetike
- ☐ novelë





18. Ç'funktion kryen fjala me të zeza në fjalinë e dhënë?

E ka qerpikun si krahi i dallëndyshes.

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- ☐ kallëzues
- ☐ përcaktor
- ☐ kundrinor
- ☐ rrethanor
- ☐ kryefjalë

19. Në shembullin e dhënë më poshtë, **ngjyros rrathët poshtë përgjigjes së saktë, duke gjetur grupin emëror të kryefjalës.**

Albi i vogël, fqinji im shkruan çdo ditë.

- ☐
- ☐
- ☐
- ☐





20. Lexo me vëmendje.

KËNGË PËR VDEKJEN E SKËNDERBEUT

Cila erë do ta rrëmbejë vallë këtë trup? O, sa orë hareje shpresoi ai dhe s'pati kurrë! Të rrethuar nga rrufe e dallgë ne s'dimë ku iku toka: mbetëm ne në këto vise. Pse, moj re, ti çahesh dhe hap një qiell të bardhë mbi viset e vendlindjes? Edhe veriu fryn më fort dhe duke na harruar shkon mbi det. Ndofta nuk e di se për fatin tonë të zi ne jemi brengosur. Ja, lindi agimi i vendit tim. Po shoh prapë fushat e zbehta dhe kodrat gjethezeza: ja shtëpitë e nënës sime, ja gratë e rritura me mua, që të ngritura pa gdhirë, dalin në dritaret e shtëpive të vështrojnë detin. Ato janë të brengosura se Skënderbeu u bë dhe. Kur u nisa unë, më pyesnin: "O Serafinë, a ke vallë një nënë që të të presë në breg dhe të të shtrëngojë me duart që i dridhen, gjymtyrët e tua të freskëta? Apo do të jesh e vetmuar atje si toka që njerëzit e shkelin me këmbë dhe s'e vënë re?"

Kambanat mbrëmë kumbonin në zi në të gjitha brigjet, se heroi vdiq: dhe ja, nëpër altare u shuan qirinjtë, veç drita e vatrës i ndriçoi shtëpinë. Në ëndërr ishin bërë mospërfillës ndaj tokës së mbjellë me pemë dhe hënë. Medet! Nga dheu nuk ngrihet më ai, në fushim vetëm çadra e tij mungon...

Po pse vallë, kur dielli u shua në mal, vajtuam se kishin humbur rrugën dhe vetë dielli mbeti pa vajtim?...

Nga Jeronim de Rada

Pasi ta keni lexuar me kujdes tekstin, në vendin e zbrazët me vizë, **shkruaj tri hollësi, me të cilat autori përshkruan zinë për vdekjen e Skënderbeut.**

1. _____
2. _____
3. _____



FAQE E ZBRAZËT



Матерњи језик - Албански



ИНТЕРНО

EKZEMPLAR PËR SHKOLLËN

Republika e Serbisë
MINISTRIA E ARSIMIT
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË
ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

TË NGJITET TIKETA E IDENTIFIKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR

TESTI

GJUHË DHE LETËRSI SHQIPE

FORMULARI I IDENTIFIKIMIT

EMRI, EMRI I NJËRIT PRIND/PËRFAQËSUESIT TJETËR LIGJOR, MBIEMRI I NXËNËSIT

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË NXËNËSIT

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

SHKOLLA FILLORE

VENDI

KOMUNA

NËNSHKRIMI I MËSIMDHËNËSIT KUJDESTAR

